



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASISTENCËSLIGJORE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE DHE KONTRATAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. 3, datë 20.06.2022

“PËR

“PJESËMARRJEN E BASHKISË VAU DEJËS NE SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QELLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA”

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të nenit 14, nenit 23, (pika 1 dhe 2), nenit 54 gërma gj) të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, të VKM nr.302, date 11.05.2022 “Per politikat kombetare per riorganizimin e sektorit te furnizimit me uje dhe te largimit, trajtimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura”, Shkresës nr. 950 prot datë 28.01.2022 dërguar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë, i propozojmë Këshillit të Bashkisë, të:

V E N D O S I:

1. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë, në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, për të negociuar me bashkite e Qarkut dhe/ose bashkite nga qark tjetër në afersi gjeografike si dhe Ministrinë e Infrastruktures dhe Energjisë, për mundësinë lidhjen e marrëveshjes specifike për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së mësipërme në zonat e shërbimit .(kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura).
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm i Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës” qe pas krijimit të Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta ku Bashkia do të jete aksionare, të vijojë me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionareve të autorizimit për Administratorin e Shoqërisë Aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës”, për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktore dhe noterial me qëllim transferimit të veprimtarisë ekonomike për tek shoqëria e re SKP-UK qe do të krijohet.

3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritit, Shoqëria e Ujësjetës Kanalizime Vau Dejës, përndjekjen dhe zbatimin e vendimit.
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjeherë sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI
Mark Babani



RELACION

PËR

“PJESËMARRJEN E BASHKISË VAU DEJËS NË SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA, ME QËLLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM , GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b” dhe pika 1.6, shkronja “b”, nenit Në mbështetje të Nenit 14, Neni 23, pika 1 dhe 2, Neni 54 gërma gj, të Ligjit Nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Neni 12 i Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996 “ Për kuadrin rregullator te sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar; Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; VKM Nr. 431, datë 11.07.2008, “Për krijimin, organizmin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”; VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimn e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura”; Shkresë Nr. 950 Prot, datë 28.01.2022, dërguar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, i propozojme Këshillit Bashkiak të autorizojë lidhjen e marrëveshjes specifike me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujrave të ndotura në zonat e shërbimit, në territorin tonë administrativ.

Me shkresën nr 950 prot, datë 28.01.2022, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise, ka vënë në dijeni bashkinë që Qeverisja Qendrore, ka si synim dhe sfide ristrukturimin e shoqërive të ujësjellës kanalizimeve, për të përmirësuar dhënien e shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura si dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standartet e Bashkimit Evropian dhe me objektivat e zhvillimit të qëndrueshem.

Duke qenë sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve ka pasur performancë të dobët, me nivele të larta të humbjeve dhe duke qenë se shoqëritë kanë nevojë për mbështetjen e autoriteteve qendrore për përmirësimin dhe administrimin e aseteve te saj, përmirësimin e gjendjes se saj financiare dhe sigurimin e burimeve të financimit për investimet e nevojshme në zonat e saj të administrimit.


Referuar situatës së lartëpërmendur , Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë propozon bashkimin e shoqërive të UK Shkodër, UK Fushë-Arrëz, UK Pukë, UK Vau Dejës dhe UK Malësi e Madhe dhe krijimin e një Subjekti me Kompetenca të Përbashkëta (SKP) të Ujesjellës Kanalizimeve sh.a , me objekt veprimtarie ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave

të ndotura urbane, në territorin e hartës fizike të propozuar, dhe do të funksionojë mbështetur në Ligjin për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. SKP-ja, do të ketë aksionerë Ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe bashkitë respektive. Bashkëpunimi midis Autoritetit Qendror dhe Njësive të Qeverisjes Vendore , konsistonë në mirëkuptimin, kontributin për realizimin e qëllimit të kësaj marreveshje, reciprocitetin, pa cenuar autonomine vendore.

Për sa më lart, i propozojmë Këshillit Bashkiak , të autorizojë pjesëmarrjen e Bashkisë Vau Dejës në subjekte me kompetenca të përbashkëta, me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm , grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, në territorin tonë administrativ.

Duke shprehur në miratimin e këtij materiali nga ana juaj,

Per Sektorin e Asistencës Ligjore
Pergjegjes
Kristine Shtatri



Kryetari
Mark Babani

